

INTERVISTË ME MUHAMET BICAJN

Prizren | Data: 29 nëntor, 2024

Kohëzgjatja: 63 minuta

Të pranishëm:

- Muhamet Bicaj (i Intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Adea Batusha (Intervistuesja)
- Ana Morina (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zoti Muhamet, nëse mundeni me na tregu diçka për kujtimet e juja t'para, për shkollën ku keni viju, familjen ku jeni rritë?

Muhamet Bicaj: Unë kam lind në Vrellë të Istogut ku kam kry edhe shkollën fillore, shkollën fillore atje. Pastaj shkollën... '58-'59 jom regjistru në Shkollën Normale në Prishtinë. Atëherë ka qenë e vetmja shkollë normale në Kosovë. Ku edhe kom diplomu në vitin '63. Në vitin '63-'64 jam regjistru në Fakultetin Filozofik në Prishtinë, atëherë u kanë Dega e Kimisë. Kom diplomu me 6 janar 1969. Domethanë 1969 kam kry Fakultetin Filozofik Drejtimi i Kimisë. Atëherë ka qenë krejt degët. Unë pastaj atë fakultet kur jom bo prorektor e kom nda. Fakultet Filologjik dhe krejt degët disa degët kiminë, fizikën, filozofi gjuhë shqipe, albanologji e tjera e tjera.

Domethanë kom diplomu në 1968-ten. Pastaj kom punu si kimist atëherë në Odën Ekonomike disa muj. Pastaj në Ballkanin e Suharekës, shef i laboratorit kimike, atëherë ka qenë industria ma e zhvillunja në atë Jugosllavi e mu m'patën marrë atje si shef i laboratorit në Ballkanin e Suharekës. Pastaj me 1 tetor 1972 jam zgjedhë asistent në Fakultetin Filozofik Dega e Kimisë. Atëherë u kanë bashkë krejt filozofiku kimia e krejt. Fakultetin e Shkencave Natyrore domethanë. Fakultetin ku kom dhanë mësim në atë kohë. Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Stomatologjisë e tjera. Pastaj jom regjistru në studime pas universitare në vitin 1970-'71 në Zagreb. Domethanë atje jom shku.

Bile nuk kom shku se atëherë shkojshin në Beograd anej knej, unë kom shku drejt në Zagreb. Ku m'kanë çu Dervish Ruzhaja, Gazmend Zajmi, kta. Kiminë jom regjistru në Zagreb domethanë kiminë fizike organike. Atëherë ka qenë drejtimet speciale. Domethanë drejtimin fiziko organike ku kom pasë fat me pasë profesora të njoftur nobelista, sidomos po e përmendi Vladimir Prelogu. Profesor Vladimir Prelogu i cili pastaj gjatë atij revolucionit që uo anti-serb në Zagreb ku kom qenë edhe unë nifar' aktivisti i studentëve e tjera e tjera. Ai pat' ikë pat' shku në Zvicërr.

Në Zvicërr osht' rektor i Universitetit ETH-aja, universiteti ma i madh n'botë. Kur e kom vizitu kom pasë nderin me vizitu sepse unë jom ai që i kom hapë shkollat shqipe dhe kom organizu diasporën në krejt botën, edhe në Zvicërr edhe në Gjermani, në Amerikë e tjera. Domethanë unë i kom hapë shkollat shqipe atje. Ato kom pasë nderin me e pa kur m'ka taku... kur e kom taku në Zvicërr ai meniherë ka

dalë, çfarë pritje m'ka bo, janë çudit krejt qysh tash mu nobelisti po m'çon nëpër restaurante anej e knej.

Se thotë, “Nuk ka qenë ai revolucionari anti serb në Zagreb. Komiteti shqiptar ka qenë shumë i zhvillun, ndër ta edhe unë”. Ai nuk ek a harru kurrë atë punë. E patën largu serbët krejt prej Zagrebit. Kshtuqë u bona nifar’ aktivisti atje. Pastaj u regjistrua në Zagreb këtë drejtimin e shkallës të tretë kimi fizikë organike viti ‘70-’71 ku kom magjistru me 21 janar 1977. Kom magjistru në Zagreb atje. Pastaj, këtë universitet e kom punu doktoratën. Kom pasë nderin me pasë profesora shumë t’mirë. Doktoratën dhe punova dhe doktoraturën 12 maj 1984 në kiminë fizike organike jom regjistru. Pastaj, aty edhe kom diplomu në qat’ kohë.

Në tetor 1972 u pranua asistent i kimisë, Fakultetin Filozofik, atëherë ka qenë Fakulteti Filozofik me kimi, me fizika me krejt. U bona asistent. Në Fakultetin e Shkencave Matematikore Natyrore kimi. Ku kom dhanë për shembull mësim në, jo vetëm në Fakultet të Kimisë po edhe në farmaci, mjekësi dhe stomatologji. Jam një ndër themeluesit të Fakultetit të Mjekësisë, farmacisë dhe stomatologjisë. Kur shkoj n’fakultet atje mjekësia anej e këndej për stomatologji e tjerë, krejt më orientun, “Hajde prof te une, hajde prof te une”. Këto ditë bile m’i kanë rregullu dhomt (qeshë). I kom gjithë ata studenta t’mi tash janë profesora dhe asistenti në Fakultetin e Mjekësisë.

Domethanë kur kom punu si asistent kimi, mjekësi, farmaci, stomatologji dhe ku pastaj u avansova profesor si domethanë, atëherë profesor i universitetit isha. U avansova në tituj ma t’lartë. Prej asistentit në profesor ordinar në Universitetin e Prishtinës. Pastaj, këta te puna e universitetit Dervish Ruzhaja u ndrronte rektori. Për herë t’parë pat’ ardhë rektor serb. Atëherë kanë mendu ata kush osht’ ai prorektor që mundet me ju kundërvu ktina, Fehmi Agani, Dervish Ruzhaja, unë isha prorektor i fakultetit të shkencave. Erdhën më morën tha, “Me ardhë në Fakultetin e Mjekësisë atje me u bo prorektor... me ardhë në fakultet me u bo prorektor”, sepse vijke serb rektor.

Atëherë pat’ ardhë Boro Colakovic, një malazez. I cili ka qenë shumë pozitiv. Në Fakultet të Mjekësisë ka qenë profesor edhe i njekun prej serbëve të Malit të Zi gjente strehim në Prishtinë. Atëherë unë u bona prorektor i Universitetit i Prishtinës. Ku faktikisht unë e kom lujtë rolin edhe rektor edhe krejt n’atë kohë që ka qenë shumë, shumë me rëndësi... domethanë vitet ‘83, ‘84, ‘85. Në këtë periudhë në Universitet të Prishtinës deri ‘85, ‘86. Si prorektor i universitetit pastaj patën bo Ibrahim Rugova këta Ministër i Arsimit i Republikës së Kosovës. Ku kam qenë ministër i viteve të ‘90-ta, ‘99. Kohnat ma të vështira ku u organizu shtëpitë shkollë.

Pastaj kur ishin këto bisedat për plan programe mësimore atëherë ishin në nivel të Jugosllavisë unë isha përfaqësues i Kosovës në Beograd me ni konferencë për krejt Jugosllavinë. Aty unë ishin do projekte të Sllovenisë, Kroacisë, Serbisë, Maqedonisë e tjera. Unë votova për projektet e Kroacisë e Sllovenisë, për këto projekte. Serbisë ju thashë aty, isha me bashkëpunëtorin tim Halim Hysenin drejtor i Entit Pedagogjik që ka qenë. Atë e kom pasë bashkëpunëtorin ma të mirë. Ju pata thanë, “Asni

plan dhe program që hartohet në Beograd për arsim pa pjesëmarrjen e shqiptarëve, eksepertëve nga Kosova nuk kanë me u përdorë”.

Ata serbët bojshin propagandën. Thashë, “Pytni Hilmi Hysenin”, se Enti Pedagogjik, “ku janë ato programe që i ka çu Serbia në podrum. Pse në podrum? Mos me i pa kërkush vetëm unë edhe ministri Halimi”. Të nesrit mu... domethanë ju anulova krejt planprogramet. Ju thashë Serbisë, “Asni plan program që hartohet në Beograd për arsim për Kosovën pa pjesëmarrjen e ekspertëve nga Kosova nuk kanë m’u përdorë edhe pikë”, thashë, kjo le të dihet. Në mramje mu m’thurret Stjepan Mesić-i i Kroacisë. Thotë, “Profesor, kemi marrë fletarrest 16 vjet e ke fletarrestin prej Serbisë. Nesër të lutna herët me ardhë në Shkup në aeroport edhe e ki biletën e sigurune në Slloveni në Lublanë”.

Unë prej atyhit shkova në Lublanë pastaj vendosem në Kroaci. Prej atyhit e kom këtë, si me thanë, azil që e lëshova Kosovën. Më strehun këta në asi në Kroaci. Unë isha në Kroaci edhe asistent edhe patën angazhu shumë për këtë. Kur pastaj në banesë rrisha në Slloveni aty. Kisha shansë se kryetarin e Akademisë së Shkencave në Kroaci e kom pasë në komision të doktoratës në Zagreb. Më kujtohet komisioni për doktoratë. M’ka pritë jashtëzakonisht shumë... ata më strehuan, sllovenët më strehuan edhe thanë, “Mos dil”, se kisha fletarrest unë. Kur pyt Ibrahim Rugovën, Fehmi Aganin, “Ku është Muhameti? Ku mundemi me gjetë?” Vitet e ‘90-ta domethanë. Filan vend anej e këndej. Erdhën. M’tha, “Prej sot je Ministër i Arsimit i Republikës së Kosovës”. Në ekzil unë. “Po qysh?” “Hiç”, tha, “Ministër i Arsimit”.

Më bonën Ministër të Arsimit, qatëherë u kanë vitet e ‘90-ta e sene. Unë pastaj shkova në Gjermani. Aty fillova m’i hapë shkollat shqipe nëpër krejt botën. Diasporën. Organizimin e diasporës së shqiptarëve unë e kam organizu. Me Europë, me Angli, me Amerikë. M’kanë përkrahë jashtëzakonisht shumë, shumë, shumë. Jashtëzakonisht shumë. Aty masanej prej atyhit u bona ministër në ekzil unë. Shkoj... bashkëpunëtor t’mirë e kom pasë Halimin edhe Rexhep Osmanin. Atëherë Rexhep Osmani bile i thojshin Ministër i Arsimit asi (qeshë) në Kosovë. Halimi Enti Pedagogjik. Ata i kom pasë bashkëpunëtorët kryesor. Krejt këto programet që i bojshim bashkë me Shqipëri anej këndej i thirrsha ata i bojshim. Ata i kom pasë faktikisht punëtorët ma t’mirë që i kom pasë.

Ato planprogramet e sene u pavarësun komplet prej Serbisë. Pastaj unë kam, ndërkohë kom shkru edhe tekste shkollorë Njeriu Natyra prej klasës të tretë, katërt, pesë. Pastaj, kimiat unë jam autorë i kimiave me disa bashkëpunëtor që i kom pasë si asistenta. Kshtuqë e sigurm fatkisht literaturën e shkencave natyrore si kimi, fizikë, biologji i angazhova krejt asi... po unë jam autorë i kimiave komplet. Bile me thanë të vërtetën Kiminë e klasës të dymbëdhjetë edhe gjermanët ma kanë marrë. Në atë kohë e vendosshin në ni komision për libra kur dojshin me i verifiku ish ai komisioni europian. Unë e shkrova ni kapitull të veçantë për droga në kiminë e dymbëdhjetë.

Ai i Zagrebit po m’thotë tha, ai gjermani, “Pse”, tha, ky i Zagrebit ish edhe njo gjerman. “Pse”, tha, “ky kapitull i veçantë?” Unë atëherë kom udhëtu shumë nëpër Europë dhe kur u nalsha në Zagreb në

Gjermani të stacionave të trenave plot të ri drogirash nëpër staciona të trenave, plot, plot. “Sepse”, thashë, “m’ka ra rasti shumë me udhëtu”, thashë, “po kur kom zbrit për shembull në stacion të trenit ose në aeroport në Gjermani”, thashë, “kom pa t’ri natën në stacionin e trenit për shembull krejt t’ritë në gjum, plot”, thashë, “e kur ka këtu kso rastesh m’shkoj menja”, thashë, “ju e dini që popullata ma e re osht’ Kosova. Atëherë unë u inspirova dhe shkrova special për droga”. Ai, “Ja, ja”, gjermani.

E morën librin dhe atë librin e ka marrë gjermani, atje e ka. Special osht’ për droga. Kapitull i veçantë të gjitha llojet e drogave. Ku merren, qysh kanë mundësi të rinjtë e tjera, e tjera. M’shkoj puna qashtu. Pastaj unë në Gjermani si kisha azil domethanë dhe isha faktikisht përfaqësues ambasadën e kishin, ambasadën e kishim në Gjermani atje. I hapa shkollat shqipe shumë m’patën përkrahë gjermanët, jashtëzakonisht shumë. Në disa qytete... domethanë në krejt Europën unë i hapa shkollat shqipe. Në Angli për shembull shkova në Oxford atje e pata mbajtëni ligjeratë edhe m’pritën ata jashtëzakonisht shumë mirë. Se disa profesora që i kom pasë atëherë në Zagreb kanë qenë bash të Oxfordit.

I hapa shkollat shqipe edhe në Angli, nëpër Francë, në të gjitha trojat shqiptare. Në Amerikë... domethanë në Suedi... a e din çfarë shkolle Suedia? Sot hala janë shkollat shqipe atje. Në Norvegji... domethanë të gjitha këto shtetet e Europës shkollat shqipe unë i kam hapë. I kemi caktu edhe mësuesit. I kemi pregadit në Kosovë. Edhe seminare për atje. Diaspora osht’ jashtëzakonisht shumë edhe më thërrasin shpesh. Bile mysafir e kom njo të diasporës, i Norvegjisë, ktu osht’ (qeshë). Nalt osht’. Dul pare andej këndeje. Kshtuqë m’shkoj koha në Kosovë pastaj diaspora edhe autor i teksteve shkollore dhe tash jom penzioner.

Anita Susuri: I kemi disa pyetje për krejt këto fazat jetës që i përmendët po kisha dashtë me fillu prej shkollimit fillor për shkak se ka qenë koha pas Luftës së Dytë Botërore. Si ka qenë për juve?

Muhamet Bicaj: Po, ajo shkolle shtëpi që u bo atëherë.

Anita Susuri: Jo, jo. Ju kur keni qenë nxanës.

Muhamet Bicaj: Aha. Shiqo. Ka qenë nivel. Me të thanë të vërtetën prej shkollës fillore deri në të mesmën kanë qenë mësuesit ma serioz, ma t’mirë që kanë qenë. Kanë qenë seminare e tjera... kur kam qenë në normale, Shkollën Normale këtu se atëherë ka qenë e vetmja shkolle në Ballkan Shkolla Normale këtu në Prishtinë. Kur kanë ardhë prej Shkupit, prej Maqedonisë, prej Malit të Zi prej viseve e krejt... bile unë e kom organizu që krejt viset shqiptare... sot më respektojnë për shembull këta të Serbisë shqiptarët e Preshevë, Bujanoc e tjera. Krejt i patëm regjistru, plot. Konviktet e t’gjitha ato. Kanë qenë vërtetë nivele.

Mu m’kujtohet kemi pasë në normale profesor prej Shqipërie, Tajor Hatipin nuk e harroj kurrë. Ai ka qenë ndër profesorët ma t’mirë në Shqipëri ku e kemi marrë... p’e marrë Tajor Hatipin se kemi pasë edhe tjerë, edhe tjerë. Po ai në normale pat’ ardhë. Na jepke shkencat metodike, pedagogjike. Pat’

organizu... jashtëzakonisht Shkolla Normale ka qenë në Prishtinë atëherë faktikisht universitet. Prej krejt trojeve shqiptare Normalja e Prishtinës ka qenë atëherë. Ajo mu m'ka shërby jashtëzakonisht shumë. Konviktet i kemi pasë... ata e kemi pasë si shtëpi.

Besoni edukatoreshat i kemi pasë femnat, a din çfarë edukate ju bojshin. Qysh me u veshë në fustana të gjatë e tjera e tjera. Na kontrollojshin, i kontrollojshin sidomos femrat a i kanë palu teshat mirë, a po pastrohen, a po lahen. Domethanë e kemi pasë faktikisht shtëpi. Shtëpi dhe ato pedagog dhe pedagoge i kemi pasë nana. Janë kanë në nivel të jashtëzakonshëm. Kshtuqë kam atë nuk e harroj kurrë për shembull, kurrë. Sidomos Tajor Hatipi ai u kanë i hatashëm. Tani ka dhanë metoditë, pedagogji e këto.

Anita Susuri: E gjatë Shkollës Normale a keni jetu në Prishtinë a keni udhëtu?

Muhamet Bicaj: Jo, në internat. Ka qenë internati jashtëzakonisht i mirë dhe i madh. Prej krejt trojeve shqiptare në internat. Besoni, kur kemi udhëtu të shtuneve dhe të dieleve me autobusa, qito shpijat poshtë na lshojke autobusi. Vishin profesorat, se u dufke me shku prej ktu deri atje n'kamë. Atëherë jemi kanë t'ri ka pasë qen anej këndeje. E dishin kur vjen t'dillen në mramje kur vjen autobusi, vishin profesorët edukatorët na pritshin aty, na merrshin na çojshin deri atje. Çfarë interesimi e çfarë respekti ka qenë, çfarë organizimi i hatashëm.

Me të ardhë për shembull profesori kujdestar, kujdestar u bojshin e dijsin kur vjen autobusi. Se autobusi vijke deri këtu poshtë, qysh i thojnë, te shpija e Fadil Hoxhës, ato ëmbëltoret ku janë aty, qato... na pritshin e në kam, atëherë në kam na çojshin. Se s'ka pasë atëherë... kjo Taukbaçja e sene krejt ka pasë derra të egër, ujqi, dhelpna anej kënej. Plot u kanë Taukbaçja. Biologji. Shpesh na bijshin aty. Krejt i shishim aty. Kanë qenë në nivel, nivel i jashtëzakonshëm.

Anita Susuri: E internati ku ka qenë?

Muhamet Bicaj: Në normale. Normalja knena aty kapt. Qajo ndërtesa tash që osht' e madhja qaty bile kur shkoj në Germi thom qe qitu kom banu une.

Anita Susuri: Tash ajo osht' Shkolla e AUK-ut?

Muhamet Bicaj: Qashtu. Universiteti Amerikan, qajo ndërtesa e madhe ka qenë internat. Këto tjerat kanë qenë shkolla. Amerikanët asi bile nusja e djalit punon në Universitetin Amerikan. Ajo ka qenë internat krejt. Domethanë në atë internat prej krejt... besoni qasi edukatorësh kemi pasë, qaso edukatoresha kemi pasë secili e kemi pasë ormanin e vet. Na i kontrollojshin a i kemi palu teshat mirë a jo. Me hekurosë ata na kanë mësu. Pantollat u kanë vendi ku për hekurosje, "Hajde tash". Vetëm ni vi u dufke me ba. Kshtuqë tash fatkeqësisht nuk janë qashtu. Po më vjen shumë keq.

Nejse atëherë ka qenë organizimi qasi soji. Ka qenë nivel. Ushqimet, internati, pastrimet... për çdo të diele na jemi kanë obligativ me hi me u la. Absolutisht. Me sapuna me detergjenta i kemi pasë krejt aty se e zgjanum pak...

Anita Susuri: E '68-ten a keni qenë aktiv ku osht' bo demonstrata?

Muhamet Bicaj: Po si jo, po si jo. Bile, bile mos thom organizator.

Anita Susuri: A ju kujtohet saktë qysh ka qenë? Qysh ka shku?

Muhamet Bicaj: Shiqo...

Anita Susuri: Çfarë dite ka qenë?

Muhamet Bicaj: Ato mu m'kujtohen ato janë kanë jashtëzakonisht shumë. Mu m'kanë deshtë shumë se Fehmi Agani, Gazmend Zajmi, Dervish Ruzhajën i kemi pasë edhe profesora në normale. Unë kam pasë fat që Dervish Ruzhajën gjyshi jem e ka çu në Universitet të Beogradit. Se atëherë s'ka pasë ktu. Axha im ka qenë ndër profesorët e parë të gjuhës shqipe, Riza Bicaj. Jusuf Gërvalla e këta nxënës të tina kanë qenë. Baba jem ndër mësuesit e parë në Kosovë anës së Istogut atje deri, me Halil Kajtazin i kanë hapë shkollat shqipe deri në Mitrovicë.

Atëherë në Beograd ka qenë universiteti. Kur shkoj mixha atje albanolog, ndër albanologët e parë ka qenë migja jem Riza Bica edhe e pyesin, i pytë gjyshi, "Ai Zaifi", Zaid Dervishi u kanë. Dervishi na thonte vet, thonte, "Gjyshi i tij ka thanë Zaif m'ka qujtë". Thotë, "Jo s'po i le baba", "Pse?" Baba e Dervishi nallman e ka pasë. Shkon gjyshi jem. Gjyshi jem ka qenë autantiv shumë. Shaban Polluzha edhe gjyshi jem i kanë pasë shpijat bashkë gjithmonë. Shkon gjyshi në Pejë thotë, "Pse p'e ndan djalin prej shokve?" Se shokët Fehmi Agani, Gazmend Zajmi, mixha jem krejt qato gjenerata. Thotë, "Valla baba s'pe len", "Çka?" Shkon gjyshi, "Pse p'e ndan djalin prej shokve?" "Po nuk kom mundësi", "Shiqo", Dervishi vet thonte, ai nallban ka qenë. "Me nda djalin prej shokve ta msheli nallbahanën. A ka pare a s'ka pare në asi".

Beso çdo të shtune gjyshi jem Fehmi Agani prej dite Fehmi Agani dhe Gazmend Zajmi krejt janë kanë të organizun të Prizrenit të Pejës ni të shtune Peja, ni të shtune Prizreni ushqimin në Beograd me tren. Thonte Fehmi Agani e Dervishi, "E dinim kur vjen treni të shtuneve vjen treni dhe aty na vjen gjithçka. Me petlla, me flija, me suxhuk me mish. E bojshim orarin", ata në internat, "kush me shku me i marrë". I kanë majtë dy vjet derisa u rregullu puna e bursave e tjera, i kanë majtë gjeneratat e Dervish Ruzhajës. E Dervishi nuk ma ka harru kurrë se isha dekan i fakultetit. Kur erdh, "Hajde prorektor i universitetit", se atëherë vijke serb.

Menojshin kush mundet me ju kundërvu dhe thojshin, “Veç Muhameti”. Se unë isha prodekan i Fakultetit të Shkencave. Profesorat ma të njohur i ka pasë. Më çoj mu prorektor të universitetit. Qishtu ka qenë kjo aktiviteti jem...

Anita Susuri: E ‘68-ten që u bonën demonstratat qysh ka qenë situata?

Muhamet Bicaj: ‘68-ten, shiqo, atëherë kom qenë unë edhe profesor asistent anej e këndeje. E kom pasë, m’kanë, domethanë, m’kanë respektu shumë. M’kujtohet i bom konviktet atëherë asi... i organizum kadale. E bom atë ekipim. Mirëpo ishte ni moment kur qaq shumë u organizun ato edhe fillun me dalë domethanë, në ekstreme. M’thotë mu Fehmia, isha unë me ta dhe me këta t’u organizu, t’u i orientu. M’thotë ni nxanës aty ni demonstrues thotë, “O’ profesor, po të thret ky Fehmi Agani dhe Dervish Ruzhaja. Qatje poshtë janë”. Se ata prej Fakultetit Filozofik knej plot.

Thotë, “Muhamet keni kujdes se janë organizu serbët kah qendra e studentëve janë organizu organizatat policore serb ushtar e anej e këtej me i pushkatu. Nja tre i kanë vra. Thuju studentëve të mos shkojnë te poshtë po në qendër”. Unë mule masanej me organizu, me bisedu me këta që ishin udhëheqësit e grupeve të ndryshme. Thashë, “Shiqoni, deri te Fakulteti Filozofik me shku ma poshtë jo se atje janë t’u ju pritë ushtria serbe dhe policia me ju pushkatu. Keni kujdes. Gazmed Zajmi, Fehmi Agani... deri te Fakulteti Filozofik me shku ma tepër jo”. Patën dalë do anej e këndeje mule me shku edhe qendrës anej këndeje. Më respektojshin mu hala më njëjshin.

Patën qenë domethanë demonstrata të jashtëzakonshme, jashtëzakonshme. Të organizun domethanë edhe Fehmi Agani, Dervish Ruzhaja, profesorat. Pat’ bo jehonë t’madhe. I pata pshtu, i pata pshtu valla.

Anita Susuri: A ke kjo ‘68-ten a ‘81-ten?

Muhamet Bicaj: ‘68-’69

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: E pastaj edhe i keni vazhdu studimet në Zagreb pas Shkollës Normale. Si u bo puna me shku në Zagreb?

Muhamet Bicaj: Po shiqo, atëherë shkojshin në Beograd anej këndeje. Po unë, Beogradin nuk e dojsa se familja ime të dënum në burgje andej e këndeje. Une shkova i pata nja dy, nja dy shqiptarë në Kroaci atje që patën pasë do firma. Bisedova me ta dhe ata thanë, “Eja këtu”. Unë shkova masanej. U takova me Stipe Vesiqi se ata organizatorët e demonstratave e sene m’çun te Stipe Vesiqi. Unë i thashë, “Shiqo”,

thashë, “unë jam familje që familja ime ka qenë e burgosur nëpër burgjet e Serbisë e sene. Unë në Beograd nuk mundem me u regjistru”.

Unë kesh regjistru i pata vazhdu studimet ni gjysëm vjetor në Beograd. Thashë, “Nuk muj”, thashë, “unë t’u kisha lutë me ma bo t’mundshme në Zagreb”, “S’ka problem”. E thirri atë rektorin dhe u regjistrova unë. Në konvikte e krejt u regjistrova në Zagreb. Ma caktun vendin e krejt dhe vazhdova studimet. Magjistratura pastaj e kreu magjistraturën. U dallova jashtëzakonisht shumë unë aty, punova une. Ma patën prur shtratin, krevetin në laborator. Unë në laborator kom flejt. N’krahësim me ata ju la përshtypje shumë e madhe atyne profesorave.

Kish reaksion që bojke pa ndërprerje 24 orë. 24 orë pa ndërprerje. Unë u dufke me nejt me to. Doktoraturën pastaj m’kanë zgjedhë meniherë. “Hajde te une, hajde te une, hajde te une”. E zgjodha profesorin ma t’njohur Sulkun në doktoraturë. Shtratin në laborator une...

Anita Susuri: Ju kiminë e keni studiu?

Muhamet Bicaj: Kiminë, po. Kimi organike. Besoni deri -20 gradë reaksionet e kimisë kanë shku te unë, -24 gradë. Çfarë asi u dufke gjithë natën me nejt aty. Ju lashë përshtypje jashtëzakonisht shumë, jashtëzakonisht shumë t’madhe. Magjistrova dhe doktorova në Zagreb. Universiteti i Zagrebit universiteti ma i vjetër në Europë, 450 vjet. Universiteti i Zagrebit. Kur kom shku në Gjermani si e përmendshin doktor edhe magjistraturë të Zagrebit, a çfarë respekti kanë ba gjermanët. Kom pasë respekt të jashtëzakonshëm në Gjermani. Po dojsha me u bo patriot, “Nuk rri këtu, du Kosovë, Kosovë, Kosovë”. Se m’kanë lutë edhe atje me punu.

Unë kom punu pak, kshtu punojsha. Për shembull kiminë unë e kam shkru... kiminë e dymbëdhjetë që e kam shkru mu ata ma kanë marrë. Gjermanët ma kanë marrë kiminë e dymbëdhjetë është e hatashme, është jashtëzakonisht shumë. Kshtuqë kom pasë nifar’ vullneti t’madh punë anej e kënde, pastaj ministër. Tash n’kohnat ma t’vështira që kanë qenë, kohna atëherë shpërngulja e nxanësve, shpërngulja e studentëve nëpër Shqipëri e tjera e tjera. Kanë qenë jashtëzakonisht kohëra shumë të vështira. Aty m’ka ndihmu jashtëzakonisht shumë Shqipëria.

Sepse në Universitetin e Tiranës dhe profesorat e Fakultetit të Mjekësisë unë i kam prur në Kosovë. Ata kanë qenë shumë t’vujtur atje. Kur kanë ardhë në Kosovë çfarë pritje ju kemi bo, çfarë vendosje ju kemi bo anej e kënde, jashtëzakonisht shumë. Kur erdh puna e shpërnguljes të nxanësve në viset malore të Shqipërisë prej Gjakovë për shembull andej, shkova atje. Më pritën jashtëzakonisht shumë. Fatos Nanon e kom pasë jaran t’madh, kryeministër atëherë që ka qenë. Beso ka organizu... i kom çu edhe vet jam shku nëpër vise veriore të Shqipërisë.

Shumë, shumë studenta që kanë qenë disa edhe asistenti, disa profesora nëpër universitete të Shqipërisë veriore i kom regjistru në Kosovë unë. M’kanë pritë jashtëzakonisht shumë. Beso e ka thirrë

Fatos Nano ministrin i ka thanë, “Krejt çka vjen nxanës nga Kosova të shpërngulur me i shti nëpër shkolla fillore shkolla të mesme, qysh e kanë nivelin”. Beso nëpër... jam shku i kom vizitu ato katune, çfarë respekti na kanë ba. Ka pasë shpi dy-tre kat që kanë qenë. Dy-tre kat kosovar të vendosur. Prej Shqipërisë veriore deri në jug krejt t’vendosur. Atëherë ato në universitete, universiteti u hapë për studenta që e lshun. Shkollat fillore të mesme po ashtu. Në qat’ kohë i regjistrova në Shqipëri, u bë jashtëzakonisht na priten shumë mirë, jashtëzakonisht mirë shumë dhe e kryen. Qiky ka qenë aktivizmi im në atë kohë.

Anita Susuri: Po, kjo vitet e ‘90-ta.

Muhamet Bicaj: Vitet e ‘90-ta.

Anita Susuri: Po po m’intereson edhe pak ma herët kur keni diplomu. A jeni kthyer prej Zagrebit? A jeni bo mjek prej këtu a po?

Muhamet Bicaj: Jo, ma së pari jom konë profesor, asistent në Fakultetin e Mjekësisë, Fakultetin e Stomatologjisë dhe të kimisë dhe bujqësisë. Dy-tri fakultete. Po kryesisht Fakultetin e Mjekësisë e Stomatologjisë unë i majtë kimiat e këto. Sot më respektojnë shumë, jashtëzakonisht shumë mirë. Ka qenë, ka qenë Fakultetin e Mjekësisë e këta kanë qenë në nivel jashtëzakonisht shumë. Për shembull dekanin atëherë isha prorektor, u bona Musa Haxhiun e bona dekan të Fakultetit të Mjekësisë. Qiky Prologu në Zvicërr m’ka thanë, tha, “Bicaj, ju e keni pasë kompleksu Universitetin e Beogradit sidomos me Fakultetin e Mjekësisë”. Po ju thom tash mjekëve, “Keni kujdes mos shkolloni prorektor, akademik se çka don Serbia”.

Fakulteti i Mjekësisë nuk osht’ tash qysh ka qenë përpara. Për fat të keq nuk osht’ i atij niveli. Nuk osht’ i atij niveli. X studenta, disa studenta e studente t’mi e mjeke sot janë nëpër Gjermani, nëpër krejt botën që e kanë lëshu Kosovën, kanë shku atje. Shpesh... i kom vllaznit atje, “Bicaj? Çka e ki profë Bicën?” Thotë, “Vlla”. Shumë më përkrahin atje sepse i kam pasë vendosë me burse e krejt. Se thashë pare m’kanë respektu. Kom pasë fat se me burrin e Merkel kisha pasë qenë në specializim në Universitetin e Moskës.

Anita Susuri: Me burrin e Angela Merkel?

Muhamet Bicaj: Me burrin e Angela Merkel. Se mu m’çoj Zagrebi në specializim në Universitetin e Moskës, universiteti ma i madh n’botë. Aty unë u dallojsha prej tyne shumë, shumë u dallojsha. Ata edhe materialisht e sene unë u dallova aty shumë. Plus disa profesora që na jepshin aty mësim, anglisht, amerikan profesora që m’kanë dhanë mu në Zagreb. E unë u dallova aty shumë. Beso kur kam shku te Merkel kur u bona ministër i shkollave shqipe dominojke vula e Serbisë. Unë e mora vulën e Republikës së Kosovës i thashë... meniherë si e ka pa kërkesën Muhamet Bicaj ka thanë burri i saj pyete, “A je kanë në Moskë?”

T'u vrapu erdh ai sekretarja e qeverisë aty e Merkel. Thotë, "Në ora kaq të pret Merkel". Ilazi po thotë, "Qaq shpejtë a? As dy orë s'janë bo", thashë, "Po e ka pa profesor". S'po më shkon menja që burri saj ka thanë. S'i jom shku Merkeli pytja e parë, "A je kanë në universitetin e Bosnjes?" Thashë, "Po", "Me burrin tem ke qenë". Jom ardhë thashë, "Ju e dini që shqiptarë ka shumë këtu, i kemi hapë kurset e shkollave shqipe në Gjermani. Vula po e shoh që po dominon vula e Republikës së Serbisë na e kemi vulën e Republikës së Kosovës. Na jemi republikë tash", "Kein Problem".

Kur mas nja dy dite ata gjysa e mësuesve studenta t'mi, "O' ministër, o' profë qy çka na ka ardhë Republic of Kosovo vula". Ndërkohë tash po ju thom vllaznive t'mi, "Merkeli", "Mirë osht' tash ta kemi çu në pension". I hapi shkollat shqipe atje krejt, andej e kënde, jashtëzakonisht shumë. Supër. Saherë kom shku m'kanë pritë jashtëzakonisht mirë shumë.

Anita Susuri: Desha me ju pytë edhe si rektorë se kanë qenë këto vitet '85-'86, me çfarë probleme jeni ballafaqu?

Muhamet Bicaj: Shiqo, unë rektorë i strukturës serbe u bo ni malazez anti serbi ikur prej Malit të Zi e i ardhun këtu, shok i Bëgracës, Bjekaj. Shok i Bjekve ma të njoftur të Kosovës të Prishtinës. Ato, ato se u dufke tash me ardhë struktura serbe. Kond me bo andej e kënde u bonën krejt shqiptarët. Ai Bekë Racaj ka qenë u kanë ndër mjekët ma t'mirë, ma autoritativ. Thotë, "Prej këtyne", se patën konkuru shumë do çetnik do kësi. Thotë, "Boshën". Se ai i ikun si anti serb, malazez. E bon Bozhidar Çollakoviç e mu m'bonën prorektor. M'ka pasë thanë Bozha mu, "Ti veç nënshkruju Bicën le rektor e krejt".

Faktikisht unë kam qenë rektor në atë kohë, ai ka nënshkru krejt se anti serb. Serbët nuk e kanë deshtë ata hiç. Çfarë revolucionit kur u bo Bozhidar Çollakoviç. Ai ndër mjekët ma t'mirë e t'vjetër në Kosovë. Shumë ia patëm pa hajrin që e patëm ba rektor ata. Faktikisht ai ka qenë veç nënshkrues i firmës, a unë kam qenë rektor i universitetit. Ja mirë shumë. Në atë kohë ka qenë universiteti në nivel. Në nivel. Shumë mirë.

Anita Susuri: E këto viti '89 kur fillun edhe demonstratat e studentëve edhe problemet domethanë. Si kanë qenë këto për ju?

Muhamet Bicaj: Po shiqo, unë... mu m'ka... ato, shiqo, ato demonstratat efektin anti serb e kanë pasë ama duhet me qenë racional mos me hupë kshtu. Ato i kanë organizu po unë ju thojsha, "Deri qitu shkoni andej kënde mos shkoni". Kshtuqë kanë qenë pozitive, në nivel pozitive. Na kanë përkrah kroatët, sllovenët, gjysa e Bosnjës, kta që kanë qenë pjesa boshnjake, malazezët. Se e kom pasë ni ekip të tërë. Atëherë na faktikisht me kroat e me sene kur ke puna republikë, unë pata shku. Pata bisedu. Na pranun.

Ibrahim Rugova atëherë u kanë në nivel. Ibrahim Rugova u kanë në nivel. Ibrahim m'ka dëgju mu shumë se ka qenë nxanës i babës tem dhe kemi qenë katune të afërta bashkë. Grunë e tij bile unë e kom pasë inkuadru në Fakultet Filozofik, grunë e Ibrahimit. U ba mirë. Jashtëzakonisht mirë. Kroatët, sllovenët, malazezët na patën përkrahë dhe na patën përkrahë... shkova pastaj në Hungari, në Hungari dhe Vojvodinë i binda se ju thashë hungarezëve, thashë, "Ju kisha lut bindni ju hungarezët që janë aty", kroatët u vendosën në atë anë, "për me votu Kosova Republikë", u organizun ata. Përveç Serbisë... Serbia mbet vetun. Kroatët... kur janë çu ata Serbia t'u mendu që janë me ta Bosna edhe Mali i Zi, nuk votoi për ne po u bindën edhe ata dhe u bo Republikë e Kosovës.

Adea Batusha: Zoti Muhamet, ishim fokusu pak te kjo pjesa e kur ke qenë ministër. Se e ceke që ke qenë në ekzil dhe u dashtë me ushtru detyrën nga largësia. Qysh ka funksionu qikjo pjesë?

Muhamet Bicaj: Mirë ka funksionu se i kom pasë, themelet i kom pasë aty. Unë thashë e kam pasë Halim Hysenin, Enti Pedagogjik. Krejt këta sekretarët e arsimit të komunave i kemi pasë zgjedhë tamon që janë kanë të orientum kështu. Ka funksionu jashtëzakonisht mirë.

Adea Batusha: E qysh ka ndodhë kontakti? Qysh jeni marrë vesh?

Muhamet Bicaj: Kontaktet kanë qenë me mu me anë të ambasadës e kanë ardhë te unë gjithmonë. Unë kam shku në Kroaci shpesh, në Slloveni jemi taku. Kanë ardhë te unë jemi taku, po, po.

Adea Batusha: E kur je kthy në Kosovë?

Muhamet Bicaj: Në Kosovë jam kthy meniherë siç u bo Republikë. Tash s'po m'kujtohet për nder.

Adea Batusha: E ky për shembull... se neve na ka ra shumë me folë për shtëpitë shkolla dhe ku janë kanë të lokalizune përgjithësisht shkollat fillore dhe të mesme. Po du me folë pak për universitet qysh u organizu pjesa e arsimit të lartë.

Muhamet Bicaj: Po, po. Shiqo shkollat shtëpi... shtëpia shkollë ka qenë nivel të jashtëzakonshëm, jashtëzakonisht shumë. Patëm bisedu na me kryetar të komunave, unë pata bisedu. I organizum shtëpijat ma të njohura që janë kanë. Shtëpia patriotike domethanë mirëpo shkolla dhe komunat. Ju ndava unë investime me iu pague shpenzimet e shkollave. Domethanë çdo shtëpi që kish shkollë merrke ni shumë të pareve. Me elektrik, me ujna, me shpenzime tjera që kanë pasë i kanë pagu. Kshtuqë i zgjodhëm edhe njerëzit shtëpiat tamon patriotike. U bo shkolla, shtëpia shkollë u bo nivel jashtëzakonisht t'madhe. Vërtetë idealizmat të hatashëm. I përkrahëm financiarisht. Financiarisht i kemi përkrahë. Special shtëpiave, në vend të shkollës, shtëpisë ia jepsha buxhetin.

Adea Batusha: Për shembull për UP-në edhe meqenëse e njeh shumë mirë Fakultetin e Mjekësisë, qysh kanë funksionu qato vjet se goxha vështirë me...

Muhamet Bicaj: Shumë vështirë, shumë vështirë ka funksionue po e patëm bo edhe aty disa ambulanta shtëpia të njoftuna që janë kanë shtëpiat ma t'mira i patëm bo ambulanta. Patëm punu në nivel patëm punu.

Adea Batusha: Qysh u kanë? A ka pasë mjete? Qysh kanë mujtë me...

Muhamet Bicaj: E kemi financu. Mjekësinë special e kom financu. Me dokumenta, me instrumente, me aso barna speciale që janë kanë... special i kena financu. U kanë buxhet i veçantë për mjekësi, buxhet i veçantë.

Adea Batusha: Si minstër në atë kohë çka mundet me qenë për ju njo prej vendimeve ma kritike që u dashtë me i marrë në qat' kohë për me majtë arsimin gjallë në atë kohë?

Muhamet Bicaj: Vendosshmëria, mos me u ndiku prej Serbisë. Apsolutisht mos me u ndiku prej Serbisë. I pavarur totalisht. Ajo ka qenë. Ajo ka qenë. Financa, shiqo... komuniteti shqiptar ka ndihmu shumë. Çdo shtëpi që ka pasë rolin e shkollës na e kemi financu, çdo shtëpi. Ajo s'ka pasë problem për nxemje, për rrymë, për shpenzime ushqimore e tjera apsolutisht hiç. Krejt e kemi financu, me emër e kemi financu. Shtëpia e Muhamet Bicës, shtëpia e kjo, shtëpia kjo, kaq, kaq, kaq janë financu. Buxhet i veçantë ka shku nëpër shpija atëherë, tamon si komunës. Jo, jo atëherë ka qenë idealizmi i hatashëm. Aty ka ndihmu diaspora, shqiptarët kanë ndihmu shumë, kanë ndihmu shumë.

Adea Batusha: Arsimi i lartë ka vazhdu njejtë?

Muhamet Bicaj: Njejtë, njejtë edhe arsimi i lartë nëpër shtëpia të veçanta. Po, po...

Adea Batusha: Kur po thu shtëpia të veçanta a bon pak me elaboru ma shumë shtëpia të veçanta në çfarë kuptimi?

Muhamet Bicaj: Shtëpia të veçanta, shtëpiat janë kanë ma të njoftuna, ma të organizune që e kanë lëshu komplet që janë kanë tamon shtëpi shkolla. E kemi financu. Kanë qenë shtëpia të veçanta për universitet, për shembull, e kemi financu tamon çka u deshtë. Laboratore, shpenzime. Plus kemi organizu në Beograd ushtrime për studenta edhe në Shqipëri edhe në Shqipëri. Shqipëria në atë kohë mjekëve kom qenë e kom pasë laboratorin edhe zyren e kom pasë ni kohë t'gjatë shumë... në Fakultetin e Mjekësisë i kemi pasë pru disa vende në Shqipëri se na pranoj mjekësia. Fatos Nano për shembull ka ndihmu jashtëzakonisht shumë.

Labororet për shembull farmaci, stomatologji, mjekësi... se unë kam qenë profesor edhe i mjekësisë. Aty i kemi çu. Se shumë profesora të Universitetit të Mjekësisë kanë qenë profesora në Prishtinë, unë i kom pasë pru. Qata kanë ndihmu jashtëzakonisht shumë. Shumë, shumë, shumë s'e harroj kurrë. Për

shembull, Fakulteti i Kimisë i shkencave natyrore që i kom pasë unë krejt shokë andej këndej kshu, komplet Fakulteti i Shkencave Natyrore i Shqipërisë ka qenë edhe i Kosovës me laborator e me krejt, me krejt.

Adea Batusha: M'u kthy prap te kjo pjesa ku e kanë lëshu qat' fletarrest për ty. Çka u kanë tamon situata?

Muhamet Bicaj: Fletarrestin unë e kam pasë po Gjermania perëndimi m'ka rujtë.

Adea Batusha: Kur u lëshu fletarrestit?

Muhamet Bicaj: Fletarresti meniherë '90-ten. Meniherë. Para '90-shit fletarresti, para '90-tshit. M'thanë sot qat' seminar që kemi pasë në Beograd a po kupton? Ish puna që kishin kandidu edhe me projekte Kroacia, Sllovania anej këndej. Unë u organizova kroatëve dhe sllovenëve me ua dhanë aty edhe asni planprogram për Kosovën që hartohet pa pjesëmarrjen e serbëve, pa pjesëmarrjen e shqiptarëve nuk ka asi. Ku janë? Podrum, podrum, podrum. Të nesërmen meniherë m'thojnë që fletarrest ki.

Ade Batusha: Ty edhe t'kanë arrestu?

Muhamet Bicaj: Jo, jom...

Adea Batusha: Hiç domethanë.

Muhamet Bicaj: Jo, jo. Jom ikë unë shpejt. Për ni ditë ditë a dy jom ikë. 60 vjet burg e kom pasë dënimin. Meniherë në Shkup jom shku në aeroplan dhe në Gjermani.

Adea Batusha: Kur reflekton për qit' pjesën e '90-tave...

Muhamet Bicaj: Gruja, gruja m'ka thanë pastaj kanë shkue se nuk kanë mendu që jam asi... t'u më përcjellë kanë ardhë civil aty t'u nejtë rreth shpije mos po dalë unë derisa e marrin vesh... në Banje të Pejës e kom pasë unë shpijen, banesën. Derisa e marrin vesh, janë marrë vesh që unë nuk jom asi... t'u përcjellë çdo ditë. Kojshitë i kemi pasë shumë t'mirë, të organizun. T'u përcjellë. Se ka pasë edhe serb aty. Ata i kanë caktu t'u u sillë anej. Derisa e kanë kuptu që nuk osht' aty. Kanë hallakat, kanë hy në shtëpi, kanë gjetë dokumenta... kshuqë në ekzil, çka me ba? Ka vujtë, familja jem ka vujtë prej tyne shumë. Shumë ka vujtë.

Anita Susuri: E që e përmendet që keni pasë n'familje të burgosur politik, kush ka qenë?

Muhamet Bicaj: Po, gjyshi me dy vllazër. Në Goliotok kanë qenë.

Anita Susuri: Para luftës?

Muhamet Bicaj: Para luftës, para luftës. Në Goliotok. Gjyshi jem ka qenë anti serb. Ai ka qenë i lidhur me Shaban Polluzhën thashë gjyshi jem, i njohur. Gjyshi jem dhe dy vllazën kanë qenë të burgosur në Goliotok. Unë kurrë bursë s'kam pasë prej Istogut. Se armiqësore. Unë për shembull, djali i mixhës, tjetri djalë i mixhës që kemi qenë në nivel të fakultetit na bursa s'kemi pasë kurrë. Apsolutisht hiç. Kemi qenë gjithmonë... ose baba jem ka qenë ndër msusit e parë në Kosovë.

Dy-tri vjet nuk e kanë pranue derisa kanë ardhë prej, kta, kto katunet e Mitrovicës. Prej Mitrovicës që asi shkollat s'kanë pasë msus e kanë thirrë babën dhe baba në Mitrovicë në ato shkolla me Halil Kajtazin kanë qenë mësues të atyne shkollave. Në Vrellë në Istog s'e kanë pranë babën tem se armik, armiqësor. Ndër msusit e parë në Kosovë ka qenë.

Anita Susuri: A keni pasë ju pastaj naj problem, ju personalisht për këtë arsye?

Muhamet Bicaj: Po normal. Unë bursë nuk kom pasë fare hiç.

Anita Susuri: Diçka tjetër që ju kanë përndjekë ose...

Muhamet Bicaj: Jo, m'kanë rujtë, shiqo, m'kanë respektu kolegët e asi... megjithatë unë, nejse policia e këto ministritë e punëve të brendshme nuk m'kanë asi po qytetarët e asi udhëheqësat m'kanë respektu. Se babën msusi i parë u kanë baba jem. Gjysën e atyne udhëheqsave i ka pasë nxanës. Mixha profesor i parë i gjuhës albanologjike ka qenë a po kupton? Jusuf Gërvalla e kta... domethanë katunet na kanë deshtë vetëm shteti jo. Mu bursë s'më kanë dhanë. Komuna për shembull, administrata e komunës bursë s'më kanë dhanë se osht' armik. E qishtu e kemi pasë.

Anita Susuri: E me u kthy pak prap te vitet e '90-ta po kthehemi. Ju domethanë gjatë gjithë kohës keni punu jashtë apo ka pasë raste kur keni ardhë në Kosovë?

Muhamet Bicaj: Jo, jo s'kam qenë derisa...

Anita Susuri: Edhe kohën e luftës edhe pas luftës?

Muhamet Bicaj: Po, po. Për shembull komandantin kryesor të ushtrisë ky, si e pat' emrin bre ai Bicaj? Prej Bosnjes ka qenë, komandant në Bosnje e pata pru aty. Na ushtrinë se organizimin e këto unë e kom bo kryesisht kom ndihmu prej jashtit shumë, me ndihma e sene jashtëzakonisht shumë, shumë. Se prej lufte e masanej m'kanë përkrahë. Masanej s'kom pasë rrezik.

Adea Batusha: Zoti Muhamet n'cilat vende t'ka ra me jetu në qit' periudhë? Ku ke qenë?

Anita Susuri: Në perëndim?

Adea Batusha: Se s'ke nejt veç ni vend a po?

Muhamet Bicaj: Në Gjermani kam qenë. Kryesisht e kam pasë... ma së pari kam qenë në Kroaci. M'ka majtë Kroacia shumë, pastaj sllovenët. Kryesisht Kroaci, Slloveni kam qenë dhe pastaj shkova në Gjermani. M'thirrën ata komuniteti shqiptarë se i pata hapë shkollat shqipe.

Adea Batusha: Domethanë në qit' periudhë ka ndodhë hapja e shkollave shqipe në...

Muhamet Bicaj: Po, po. Kryesisht atje, kryesisht atje.

Adea Batusha: Çka ka qenë roli yt në hapjen e shkollave shqipe? Çka ju ka ra me bo?

Muhamet Bicaj: Vendime. Vendime si Ministër i Arsimit i Republikës së Kosovës. Me vendime dhe edhe mëesuesit i caktojsha. Bile m'kujtohet Agim Ramadanin se e kom pasë jaran, e kom pasë vizitu, ai ka qenë trim i madh në Zvicërr. Kur i hapa shkollat shqipe i caktojsha mësuesit, gruja e tij ish kanë mësuese. E boj mësuese me vendim. Si e ka marrë vendimin... se more me mend, ministreshë e Zvicrrës e arsimit kishte pasë qenë shqiptare e Kroacisë. Si jam shku atje, se u dashke me shku nëpër ministri unë.

Si e ka pa emrin Profë Bicaj, m'ka pranë. I thashë, "Shkollat shqipe plus vulën e kemi", se në do shkojke vula e Serbisë ajo e vjetra që ka qenë. Thashë, "Na jemi republikë, qe vula e Kosovës". Tha, "S'ka problem". Thashë, "Qita mësues që i kom caktu", ia çova listën, thashë, "ju kisha lutë me i asi", "S'ka problem". Dul me m'përcjellë se aty s'guxojke me folë n'zyre. Tha, "Edhe unë jam shqiptare, albanezë e Kroacisë". Ajo pjesa e Kroacisë e ka tokë shqiptare bregdetin aty. Edhe e caktova mësuese grunë e Agimit me vendim. Me atë vendim të grusë, Agimi e murr vendimin se pa vendim, e murr vendimin qëndrimin në Zvicërr.

E ka pasë masanej ka pasë hap ni sallon të pikturës, piktura e m'thirrke. E vizitojsha. Rrisha shumë andej këndej. Derisa më çon fjalë, thotë, "O' ministër, nesra u nisa unë për Shqipëri me Sali Çekun". Sali Çekun e kom pasë në zyre, çfarë djali u kanë. Krejt shqiptarët e asi ju ka pasë rregullu dokumentat, se ky administrator i mirë. Me vulë. Tha, herë ministër ma bojke herë profë, tha, "Shkova", "Ku?" "Me Agimin shkum". Shkun në Shqipëri. Se unë kam qenë shef i emergjencës gjatë luftës.

Anita Susuri: Ku?

Muhamet Bicaj: I luftëtarëve kosovar. I kom pasë siguru kalimet andej e m'ka pasë respektu Shqipëria veriore shumë, shumë, shumë.

Anita Susuri: E në Kosovë jeni kthyer menjëherë pas luftës? Në '99-tën?

Muhamet Bicaj: Po mas luftës.

Anita Susuri: Kur?

Muhamet Bicaj: Kom harru tash me datë s'e di veç jom kthyer.

Anita Susuri: Pas përfundimit domethënë?

Muhamet Bicaj: Po, po pas përfundimit.

Anita Susuri: E pastaj edhe m'duket jeni inkuadru në hartimin e teksteve...

Muhamet Bicaj: Po, po masanej kam qenë edhe shef i Librit Shkollor. Se e pata hapë... Libri Shkollor ka lujtë rol jashtëzakonisht të madh. Bajram Shatri për shembull u kanë... rol jashtëzakonisht të madh. Unë u bënë shef i grupit për hartimin e teksteve shkollore. Organizova gjitha edhe prej Shqipërisë i pata prurë për gjuhë, për histori, për gjeografi e tjera. Unë vetë kisha qenë ishë. E pata hapë kufinin për shkollat shqipe krejtësisht që është e mundur. Organizova pastaj me autor nga Shqipëria bashkë me kosovarë që është e mundur e tjera. Libri Shkollor ka lujtë një rol shumë të madh se e hapi krejtësisht me bashkëpunim me Shqipëri, me libra të Shqipërisë, me të Kosovës dhe i bashkëpunim me tekstet shkollore, i shpërndam në krejt Kosovën.

Anita Susuri: Mirë. Zoti Muhamet, ju faleminderit shumë!